V E N D I M
Nr. 107, datë 31.3.2002

PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, TË CILAT PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR DURRËS-RROGOZHINË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 1, 20 dhe 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", me propozimin e Ministrit të Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme të pronarëve, të cilët preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Durrës-Rrogozhinë, (lidhja By-pass e Kavajës me rrugët hyrëse Kavajë).

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqet 883 m2 tokë/arë, 500 m2 truall, vlerësuar në shumën e përgjithshme prej 2 209 600 (dy milionë e dyqind e nëntë mijë e gjashtëqind) lekësh.

4. Vlera e shpenzimeve procedurale të jetë në shumën prej 200 200 (dyqind mijë e dyqind) lekësh.

5. Fondi prej 2 409 800 (dy milionë e katërqind e nëntë mijë e tetëqind) lekësh, sipas pikave 3 dhe 4 të këtij vendimi, të përballohet nga Buxheti i Shtetit i vitit 2002 në zërin "Shpronësime", miratuar për Ministrinë e Transportit dhe Telekomunikacionit.

6. Shpronësimi të përfundojë brenda datës 30.5.2002.

7. Ngarkohet Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMNISTRI
Pandeli Majko

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAVAJË

LISTA E PERSONAVE QË SHPRONËSOHEN

	Pronar			Nr.parc.		Truall			Tokë bujqësore			Totali	Shënim
Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri		Nr.z. kadas	M2	Lekë/ m2	Lekë	m2	Lekë/m2	Lekë	Lekë	
1	Osman	Alush	Hoxha	17/88	3817				230	1200	276000	276000	
2	Bedri	Rrapush	Hoxha	17/89	3817				225	1200	270000	270000	
3	Rrapush	Alush	Hoxha	17/90	3817				78	1200	93600	93600	
4	Bajram	Alush	Hoxha	17/91	3817				110	1200	132000	132000	
5	Bilal	Alush	Hoxha	17/92	3817				51	1200	61200	61200	
6	Irfan	Selim	Hoxha	17/93	3817				23	1200	27600	27600	
7	Fatmir	Selim	Hoxha	17/94	3817				43	1200	51600	51600	
8	Rustem	Jakup	Hoxha	17/95	3817				45	1200	54000	54000	
9	Kujtim	Rustem	Hoxha	17/96	3817				28	1200	33600	33600	
10	Kasem		Hoxha						25	1200	30000	30000	
11	Hekuran	Kasem	Hoxha						25	1200	30000	30000	
12	Bashkëpronarët Biturku			94/6 1/12	3101	125	2300	287500				287500	

13	Kastriot	Ramadan	Llakaj	1/11	3101	375	2300	862500				862500	
	Shuma					500	2300	1150000	883	1200	1059600	2209600	

Mbyllet me numër rendor 13.

Shpenzime procedurale për publikimet 200 200 lekë.

Vlera totale për shpronësimin 2 409 800 lekë.

KRYETARI I KOMISIONIT

Sadetin Stankaj

DREJTORE

Miranda Shuli